




Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	7813	2022	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.952/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti –kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.921/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me

Ankesën me numër A.nr.939/2022 të datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesi Burim Shehu me adresë si dhe Ankesën me numër A.nr.952/2022 të datës 26.10.2022, e parashtruar nga ankuesja me adresë të banimit në Komunën e Prishtinës, të bashkuara sipas vendimit të kryetarit të këshillit VK.Nr.177/2022 të datës 30/11/2022 dhe të cilat ankesa kanë marrë numrin e lëndës A.nr.952/2022,kundër organit të punësimit/Organit Shqyrtues të Prokurimit, në çështjen juridike “Ndërrprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.921/2022 e datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesja , ankesa A.nr.939/2022 e datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesi si dhe ankesa A.nr.952/2022 e datës 26.10.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbeten në fuqi Vendimi Nr.818/222 i datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies se punës për ankuesen Vendimi Nr.820/22 i datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies se punës për ankuesin si dhe Vendimi Nr.819/22 i datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies së punës për ankuesen të lëshuara nga ana e Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

A r s y e t i m

Ankuesja ka qenë e punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, sipas Akt emërimit Nr.prot.117/2020 të datës 01.04.2020, në pozitën “Zyrtare për teknologji” në Divizionin e Brendshëm, ankuesi ka qenë i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit,

sipas Akt emërimit Nr.05/2020 të datës 09.03.2020 në pozitën "Zyrtar i lartë ligjor" në Divizionin e Brendshëm si dhe ankuesja [redacted] ka qenë e punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, sipas Akt emërimit Nr.138/2020 të datës 04.05.2020, në pozitën "Përkthyes nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas" në Divizionin e Brendshëm.

Me datën 30.09.2022, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka nxjerrë Vendimin Nr.818/22 sipas të cilit i'a ka ndërprerë marrëdhënien e punës ankueses

Me datën 30.09.2022, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka nxjerrë Vendimin Nr.820/22 sipas të cilit i'a ka ndërprerë marrëdhënien e punës ankuesit

si dhe me datën 30.09.2022, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka nxjerrë Vendimin Nr.819/22 sipas të cilit i'a ka ndërprerë marrëdhënien e punës ankueses

[redacted] bazuar në Raportin e Monitorimit për vitin 2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për këtë institucion.

Ankuesit e pakënaqur lidhur me vendimet e lartcekura mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me datën 14.10.2022 ankuesja [redacted] ka parashtruar ankesën me numër te protokollit 6206/2022, me datën 21.10.2022 ankuesi [redacted] ka parashtruar ankesën me numër te protokollit 6370/2022, si dhe ankuesja [redacted] e datën 26.10.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6464/2022 për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrsh për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.10.2022, 27.10.2022 si dhe 01.11.2022 përmes shkresave me numër të protokollit 6465/2022, 6502/2022 si dhe 6621/2022 ankesat e ankuesve i ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit. Ndërsa Këshilli, me datat 04.11.2022 dhe 11.11.2022, ka pranuar përgjigjet në ankesat e ankuesve nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndëve në proces.

Me datën 25.11.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.171/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses [redacted] edhe për dhjetë (10) ditë pune, ndërsa bazuar në kërkesën e datës 30.11.2022 të Kryetarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me bashkimin e ankesave me numër A.nr.921/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] A.nr.939/2022 te datës 21.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] si dhe A.nr.952/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me datën 30.11.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.177/2022, sipas të cilit është aprovuar kërkesa lidhur me bashkimin e ankesave të ankuesve sipas asaj të fundit me numër A.nr.952/2022, pasi që baza ligjore dhe objekti i shqyrtimit janë të njëjta.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:6206/2022 të datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.818/22 të datës 30.09.2022 nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies se punës te ankueses; Aktvendimin AA.nr.682/2022 të datës 15.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Vërtetimin Nr.804/22 të datës 28.09.2022 për ankuesen; Kërkesën e ankueses Nr.898/21 të datës 20.12.2021; Akt emërimit e ankueses Nr.prot.117/2020 të datës 01.04.2020; Vendimin Nr.28/2022

të datës 30.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 08.06.2022 nga OSHP lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të KPMSHCK-së; Padinë e datës 08.06.2022 e parashtruar nga OSHP-ja; Konkursin me numër të referencës RN00005620 nga OSHP-ja; Njoftimin e datës 31.01.2022 për kandidatin e suksesshëm nga OSHP-ja; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2022 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës së ankueses; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës së ankueses të datës 30.08.2019; Kërkesën me numër Nr.932/22 të datës 24.10.2022 nga OSHP-ja për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor; Vendimin VK.nr.171/2022 të datës 25.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me Nr.Prot:6370/2022 të datës 21.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin e ankuesit Nr.95/20 të datës 09.03.2020; Formularin e vlerësimit të punës provuese të ankuesit të datës 08.03.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesionale për ankuesin të datës 21.01.2022; Vendimin Nr.820/22 të datës 30.09.2022 nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 30.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2022 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës së ankuesit; Formularin PDP lidhur me përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit të datës 30.08.2019; Ankesën me Nr.Prot:6464/2022 të datës 26.10.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin e ankueses Nr.138/20 të datës 04.05.2020; Formularin e vlerësimit të punës provuese të ankueses të datës 30.04.2021; Fletë lëshimin e datës 27.08.2022 nga Spitali Amerikan; Vendimin Nr.819/22 të datës 30.09.2022 nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.11.2022 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës së ankueses si dhe Vendimin VK.nr.177/2022 të datës 30.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me bashkimin e ankesave të ankuesve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesit ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se e ankesat e ankuesve dhe janë të pa bazuara sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve, e që ndërlidhen me ndërprerjen e marrëdhënies e punës nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 30.03.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.28/2022 lidhur me Raportin e Monitorimit për Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2020, sipas të cilit me rekomandim tek fusha e dytë për procedurat e rekrutimit dhe të avancimit të këtij raporti, ka konstatuar se me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për shërbimin civil për vitin 2020 në këtë institucion lidhur me pozitat e ankuesve si në vijim: "Zyrtare për teknologji", "Përkthyes nga gjuha serbe dhe

anasjelltas" si dhe "Zyrtar i lartë ligjor", ka pasur shkelje gjatë pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve.

Ndërlidhur me pozitat e ankuesve, Kolegji fillimisht ka analizuar dosjen e kandidates-ankueses lidhur me pozitën "Zyrtare për teknologji", sipas konkursit me numër reference RN00005624, i shpallur me datën 13.09.2019 një pozitë (1), ku si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kane qenë: Diplomë universitare; Shkenca kompjuterike dhe minimumi dy vite përvojë pune profesionale, e që bazuar ne dokumentacionin e kandidates se përzgjedhur në këtë rast ankueses, Kolegji ka gjetur se sipas Diplomës me Nr.1409 të datës 25.01.2018, e njëjta ka përfunduar studimet dhe ka marrë titullin si Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike me datën 27.12.2017, respektivisht ankuesja si kandidate e përzgjedhur për këtë pozitë nuk ka pasur dy vite përvojë pune profesionale pas diplomimit deri në datën e mbylljes së konkursit, ndërsa lidhur me dosjen e kandidatit-ankuesit për pozitën "Zyrtar i lartë ligjor", kolegji ka vlerësuar se sipas konkursit me numër reference RN00005621, i shpallur me datën 13.09.2019 për tri (3) pozita, si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë kanë: Diplomë universitare ; Fakulteti juridik dhe tri vite përvojë pune profesionale, ndërsa sipas Njoftimit të datës 30.01.2020 për këtë pozitë është përzgjedhur vetëm një pozitë, në këtë rast ankuesi dhe se bazuar me dosjen e kandidatit të përzgjedhur-ankuesit del se i njëjti ka poseduar Diplomën me numër 5100 të datës 18.10.2017, i cili me datën 13.06.2017 ka diplomuar ne Fakultetin Juridik dhe bazuar në këtë, Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ka tri vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, si dhe lidhur me dosjen e kandidates-ankueses lidhur me pozitën e punës "Përkthyes nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas", sipas konkursit me numër reference RN00005626, i shpallur 13.09.2019 një pozitë (1), si kushte të përgjithshme të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: Diplomë universitare; Gjuha serbe, ekonomik, juridik, psikologji dhe gjuhe dhe letërsi shqipe dhe minimum tri vite përvojë pune profesionale, njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve, ndërsa nga analizimi i dosjes se kandidates se përzgjedhur-ankueses, Kolegji ka gjetur se sipas Diplomës me numër Nr.5211 të datës 06.03.2017 e njëjta ka përfunduar studimet bachelor në Fakultetin e Psikologjisë me datën 13.02.2017, respektivisht kandidatja e përzgjedhur-ankuesja nuk ka pasur gjithsejtë tri vite përvojë profesionale pas diplomimit deri në datën e mbylljes së konkursit. Sa i përket vlerësimit të përvojës së punës profesionale, Këshilli përveç dispozitave të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se për pozita profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit.

Kolegji i Këshillit, bazuar si në konstatimet e mësipërme, ndërlidhur me rastin e ankuesve sipas Vendimit Nr.28/2022 të datës 30.03.2022 lidhur me Raportin e Monitorimit për Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2020, ka rekomanduar Kryesuesin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, që të ndërmarrë veprimet ligjore lidhur me eliminimin e shkeljeve të konstatuara në raport të monitorimit, që me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për shërbimin civil të veprohet në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Ndërlidhur

me raportin e monitorimit të lartcekur të Këshillit, me datën 21.09.2022, ka vendosur edhe Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, me ç' rast ka nxjerrë Vendimin AA.nr.682/2022, sipas të cilit e ka aprovuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin kishte atakuar Aktvendimin A.nr.1499/2022 të datës 12.07.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, sipas së cilës kjo e fundit e kishte aprovuar propozimin e palës paditëse konkretisht Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Këshillit për raportin e monitorimit në fjalë.

Andaj duke pasur parasysh se ndërprerja e marrëdhënies se punës se ankuesve, ndërlidhet me raportin e monitorimit të lartcekur sipas të cilit ka vendosur Këshilli, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.818/222 të datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies se punës për ankuesen Vendimit Nr.820/22 të datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies se punës për ankuesin si dhe Vendimit Nr.819/22 të datës 30.09.2022 lidhur me shkëputjen e marrëdhënies së punës për ankuesen

ka vepruar në pajtim dispozitat e nenit 60, paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe me këtë rast ka zbatuar Vendimin Nr.28/2022 të datës 30.03.2022 lidhur me Raportin e Monitorimit për Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.952/2022, datë 09.12.2022.

Ardija Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.